

VENDIM
Nr. 709, datë 26.11.2025

PËR NJË NDRYSHIM DHE DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 569, DATË 17.7.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KOMPETENCAVE, MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 569, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 10, të kreut III, hiqen fjalët “... së drejtorit të përgjithshëm dhe ...”.

2. Pas pikës 10, të kreut III, shtohen pikat 10/1, 10/2, 10/3 dhe 10/4, me përmbajtje:

“10/1. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

10/2. Kriteret për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit janë, si më poshtë vijon:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të jetë në kushte shëndetësore, që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” ose “Master profesional” të përfituar në fund të ciklit të dytë të studimeve, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike, ose të barasvlershme me ta, sipas legjislacionit për arsimin e lartë në shkenca juridike, shkenca ekonomike, shkencat e natyrës ose në fusha të ngjashme, të lidhura me funksionet e institucionit;

dh) të ketë eksperiencë pune jo më pak se 3 (tre) vjet në pozicione drejtuese;

e) ndaj tij të mos jenë marrë masa disiplinore, që nuk janë shuar sipas legjislacionit në fuqi;

ë) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

10/3. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit lirohet nga detyra në këto raste:

a) humbet shtetësinë shqiptare;

b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor apo merr formë të prerë vendimi gjyqësor për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;

c) plotëson kushtet për pension pleqërie;

ç) paraqet dorëheqjen me shkrim;

d) vërtetohet pamundësia për të ushtruar detyrën;

dh) i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;

e) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

ë) ristrukturohet institucioni.

10/4. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit shkarkohet nga detyra në këto raste:

- a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose të një kundërvajtjeje penale me dashje;
- b) kryen shkelje të rënda gjatë ushtrimit të detyrës;
- c) nuk përmbush objektivat e institucionit;
- ç) kryen veprimtari, që krijon konflikt interesash, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave;
- d) mungon në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme, për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë radhazi.”.

II. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama